



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 11.08.2017 Ref.: 673117

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Zgjatet periudha e akreditimit për programet e studimit të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” të cekura me poshtë për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2018:
 - Inxhinieri dhe Teknologji e Ushqimit, BSc, 180 ECTS, maksimumi 150 student për vit akademik;
 - Inxhinieri dhe Teknologji e Ushqimit, MSc, 120 ECTS, maksimumi 30 student për vit akademik;
 - Teknologji, BSc, 180 ECTS, (me specializime: Inxhinieri e Mjedisit; Inxhinieri Kimike), maksimumi 100 student për vit akademik;
 - Teknologji, MSc, 120 ECTS, (me specializim: Inxhinieri e Mbrojtjes së Mjedisit), maksimumi 10 student për vit akademik;
 - Vendbanimet e Lëndëve të para Minerale, MSc, 120 ECTS, maksimumi 15 student për vit akademik;
 - Xehtari, BSc, 180 ECTS, maksimumi 60 student për vit akademik;
 - Xehtari, MSc, 120 ECTS, maksimumi 15 student për vit akademik.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 28 Korrik 2017 ka shqyrtuar kërkesën e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë për ri/akreditim të programeve të cekura më sipër. Duke pasur parasysh dinamikën e përcaktuar nga AKA për formimin e ekipeve të vlerësimit dhe përcaktimin e afateve kohore për vlerësim të jashtëm, Universitetit të Mitrovicës nuk i është realizuar vizita me ekspertë të jashtëm sipas afateve të parapara nga AKA dhe rrjedhimisht është vonuar regjistrimi i studentëve të rinj në këto programe të studimit. Duke pasur parasysh që këto programe janë në ri/akreditim dhe se kriteret minimale për stafin akademik janë plotësuar, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bazuar në nenin 15, pika 3 e Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, kërkesës së Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë për riakreditim datë 04.07.2017, nr.503/17, dhe dispozitave të tjera ligjore të cekura më sipër, KSHC vendosi si në dispozitave të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimin të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

